

Lartësi Mbretërore,

Shumë të dashur Leka dhe Elia,

Të dashur Miq,

Nderin që më bëhet sot, një nder vërtet krejt i veçantë, e përjetoj jo thjesht, me përulësi, si një vlerësim.

E përjetoj mbi të gjitha si vazhdimin e njëëndrre.

Ëndrrën për ta parë Shqipërinë të zonjë për të dhënë në botë imazhin më të mirë të saj.

Kordoni i madh i Urdhërit mbretëror të Skënderbeut është një dëshmi gjithmonë e gjallë e rafinimit dhe *chic*-ut të traditave shqiptare.

Ai është pjesë e asaj ëndrre që u konkretizua një vit më parë, falë martesës suaj mbreslënëse. Ëndrra për ta bërë Shqipërinë, për disa ditë, strehën e një eventi botëror ku ajo shpaloste vlerat dhe potencialet e saj dhe kthehej në strehën e personaliteteve më të shquara të show-biz dhe të familjeve mbretërore më ekskluzive europiane.

Ka qënë për mua nder dhe kënaqësi, t'ju shoh dhe t'ju asistoj shumë modestisht, në ndërtimin dhe përmbushjen e një ëndrre personale, martesën tuaj, e cila u kthye në një shembull ëndrre për shumë shqiptarë.

E ndjej që shqipja ime, mjerisht prej shumë kohë e lënë pas dore, po më lë dalëngadalë në mëshirë të fatit, duke më kujtuar me delikatesë se nuk është mirë, në të tilla raste, të flasësh më gjatë se i zoti i shtëpisë.

Ndaj, përpara se të filloj të skuqem e të shëndrris, me tërë këto shirita dhe medalje si Plaku i Vitit të Ri, nxitoj t'ju falenderoj nga zemra që erdhët të bashkëndani gëzimin tim të veçantë sot.

Lartësitë Tuaja Mbretërore, të dashur Leka dhe Elia, nga zemra: "Merci beaucoup, je vous aime".

Faleminderit